



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës merr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 19 QERSHORIT - DITA E ÇLIRIMIT TË KOMUNËS SËPODUJEVËS

Neni 1

Për shënimin e 19 Qershorit - Dita e Çlirimit të Komunës së Podujevës, ngritet Këshilli Organizativ, në këtë përbërje:

1. **Nexhmi Rudari**, *Nënkryetar i Komunës, kryesues*
2. **Fatmir Gashi**, *Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtar*
3. **Donika Sfishta**, *Drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sporti, anëtare*
4. **Agim Blakçori**, *Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, anëtar*
5. **Agron Gërguri**, *Drejtor i Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", anëtar*
6. **Avni Fetahu**, *Këshilltar i Kuvendit të Komunës, anëtar*
7. **Fatmir Rudari**, *Këshilltar i Kuvendit të Komunës, anëtar*
8. **Fitim Haziri**, *Këshilltar i Kuvendit të Komunës, anëtar*
9. **Fahri Balaj**, *Përfaqësues i Organizatave të dala nga lufta, anëtar*

Neni 2

Këshilli merret me organizimin dhe përgatitjen e programit festiv për shënimin e 19 Qershorit - Dita e Çlirimit të Komunës së Podujevës.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

Anëtarëve

Arkivit

Nr.02-020/04-0046289/19
Podujevë,
10 qershor 2019



**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Ligjin e Punës nr.03/L-212, dhe Udhëzimin Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe për zgjedhjen e kandidatëve për tre (3) vende të punës, pozita; **Mjek i Përgjithshëm**, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, sipas konkursit me nr.prot.06-111/01-46683/19 të datës 12 qershor 2019, ngritët Komisioni, në përbërje:

1. Bejtush Jashari, *Specialist i Mjekësisë Familjare – QKMF*, kryesues
2. Selvete Hoti - Hasani, *Specialiste e Mjekësisë Familjare – QKMF*, anëtare
3. Drita Azemi, *Specialiste e Mjekësisë Familjare – QKMF*, anëtare

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:

Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Zyrës së Personelit

Anëtarëve

Arkivës

Nr. prot. 02-020/04-0047990/19
Podujevë,
17 qershor 2019



Agim Veliu
Kryetari i Komunës
Agim Veliu